

V E N D I M
Nr.605, datë 30.10.1995

PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit nr.8008, datë 5.10.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Familja që pretendon ndihmë ekonomike përjashtohet nga përfitimi i ndihmës, në qoftë se të paktën një anëtar i familjes plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

a) Është pronar i çdo lloj kapitali, me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe tokës bujqësore që përcaktohet me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë dhe Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit.

b) Është i vetëpunësuar ose i punësuar te të tjerët.

c) Është jashtë shtetit për çdo arsye, me përjashtim të studimit ose kurimit mjekësor për një periudhë mbi 6 muaj.

ç) Nuk është regjistruar në zyrën e punës si i (e) papunë dhe si kërkues pune.

d) Refuzon pjesëmarrjen në punë, kur ajo i ofrohet një anëtar i të aftë për punë dhe në moshë pune.

dh) Nuk ka paguar detyrimet kontributive ndaj shtetit në periudhën kur ka qenë i punësuar.

e) Refuzon kualifikimin dhe rikualifikimin.

ë) Ndryshon vendbanimin për arsye jo të kërkuara ose të detyruara nga shteti, duke braktisur në vendbanimin e vjetër pronat e tij dhe burimet e jetesës.

f) Nuk tërheq ndihmën ekonomike të akorduar brenda periudhës për të cilën akordohet.

g) Konstatohet se ndërmerr veprime të qëllimshme për të përfituar ndihmën ekonomike, ku përfshihen:

- shmangie të punësimit dhe kualifikimit për punësim;

- dhurim spekulativ i kapitalit;

- deklarim jo real i kushteve të jetesës;

- ndarje spekulative e një ose disa anëtarëve të familjes, që përcaktohet në ligjin nr.8008, datë 5.10.1995, neni 1.

2. Zyrat e punës, organet tatimore, Inspektorati i Punës dhe Inspektorati i Ndihmës Ekonomike kanë për detyrë të informojnë këshillat e bashkive dhe komunave për çdo familje që plotëson kushtet e pikës 1 të këtij vendimi.

3. Dokumentacioni i nevojshëm mujor që përgatitet nga kryefamiljari i familjes pretenduese për ndihmë ekonomike është deklarata e përgjithshme dhe deklarata specifike që përgatitet sipas modeleve të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

4. Anëtarët e familjes pretenduese për ndihmë ekonomike, në moshë dhe gjendje pune, duhet të paraqesin në seksionin e ndihmës dhe të përkujdesit shoqëror vërtetimin e regjistrimit në zyrën e punës, si të papunë dhe si kërkues pune.

5. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.304, datë 30.6.1994 “Për dokumentacionin e përfitimit të ndihmës ekonomike”, pika 1 shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë të përgatitë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 dhjetor 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi